

Njihni të Drejtat Tuaja



Konfidencialiteti

NYC Public Schools (Shkollat Publike të Nju-Jorkut) nuk pyesin për statusin e imigracionit të nxënësve ose anëtarëve të familjes dhe nuk e gjurmojnë këtë status të tyre. Personeli ynë nuk do të mbajë dokumente në lidhje me statusin e emigracionit që ju mund t'ua dorëzoni. Përveç rasteve kur kërkohet shprehimisht nga ligji, stafi i NYCPS-së nuk e ndan informacionin e nxënësve.

Aksesi Gjuhësor

Të gjitha shkollat publike në Nju-Jork ofrojnë shërbime përkthimi dhe interpretimi falas për familjet që preferojnë të komunikojnë në një gjuhë tjetër përveç anglishtes. Për më shumë informacion, vizitoni [## Shkolla të Sigurta](https://schools.nyc.gov>Hello.</p></div><div data-bbox=)

Për të ruajtur një mjedis të sigurt për të gjithë nxënësit, zyrtarët jolokalë të zbatimit të ligjit, duke përfshirë personelin e Imigracionit dhe Doganave (ICE), nuk lejohen të hyjnë në shkollat e NYCPS-së, përveçse kur kërkohet nga ligji dhe vetëm pasi shkolla të jetë konsultuar me avokatët e NYCPS-së. Çfarë ndodh nëse një zyrtar i ICE-së paraqitet në shkollë?

- Agjenti i sigurisë në shkollë do të njoftojë drejtorin, i cili do ta takojë zyrtarin në pikën e sigurisë. Drejtori do t'i bëjë të ditur zyrtarit se duhet të presë jashtë ndërtesës së shkollës, ndërkohë që drejtori konsultohet me avokatët e NYCPS-së.
- Drejtori do të flasë me avokatët e NYCPS-së dhe do të njoftojë prindin ose kujdestarin. Zyrtarët e ICE-së do të lejohen të hyjnë vetëm nëse kanë një urdher të vlefshëm nga gjyqësori ose nëse ndodhin lloje të caktuara emergjencash që kërkojnë veprim të menjëhershëm. Për më shumë informacion, vizitoni schools.nyc.gov/SupportingAllStudents.

A mund ta vizitohet shkollën e fëmijës tim nëse jam pa dokumente?

Po. Për të vizituar një shkollë të NYCPS-së, duhet të keni një dokument zyrtar identifikimi me fotografi. NYCPS pranon IDNYC, kartën bashkiake të identitetit që lëshohet falas nga NYC për të gjithë banorët e Nju-Jorkut.

IDNYC nuk mbledh informacion rreth statusit të emigracionit. Mund të regjistroheni për një kartë IDNYC në nyc.gov/IDNYC.

Ky burim ofron vetëm informacion të përgjithshëm. Nuk përbën këshillë ligjore. Për këshillë ligjore, konsultohuni me një avokat.



Mbroni Familjen Tuaj

Përditësoni Informacionin Tuaj

Jepini shkollës së fëmijës informacionet e kontaktit në rast emergjence, duke përfshirë emrat dhe numrat e telefonit të të rriturve (p.sh.: anëtarë të familjes, miq, dado, fqinjë ose prindër të tjerë të shkollës) që mund ta marrin fëmijën tuaj në mungesën tuaj. Këtu përfshihet çdo program 3-K, pre-K, kujdesi fëmijësh ose passhkollor që ndjek fëmija juaj.

Ka disa për të caktuar dikë që të kujdeset për fëmijën tuaj. Për më shumë informacion, vizitoni on.nyc.gov/FamilySeparation.

1. Mënyra e parë është të caktoni një person në marrëdhënie prindërore duke plotësuar një formular të NYS Office of Children and Family Services (Zyra e NYS-së për Shërbimet për Fëmijët dhe Familjet), të quajtur **OCFS-4940**. Kjo mund të bëhet menjëherë dhe nuk kërkon paraqitje në gjykatë.
2. Mënyra e dytë është përmes një procesi të quajtur **Kujdestari Rezervë (Standby Guardianship)**. Ky proces kërkon paraqitje në gjykatë.

Respekt për të Gjithë

Asnjë fëmijë nuk duhet të ndihet i pasigurt në shkollë. Për këtë arsye, NYCPS është e angazhuar të ruajë një mjedis mësimor të sigurt dhe mbështetës, ku nuk ka ngacmime, frikësim, bullizim dhe diskriminim. Nëse fëmija juaj ju tregon se ndihet i bullizuar ose i ngacmuar, ju lutemi raportojeni menjëherë çështjen te stafi i shkollës.

Vizitoni schools.nyc.gov/RespectForAll për më shumë informacion sesi të raportoni bullizimin.

Burime Shtesë

Zyra e Kryetarit të Bashkisë për Çështjet e Emigrantëve (NYC Mayor's Office of Immigrant Affairs, MOIA) - Linja Telefonike për Mbështetje Ligjore mbi Imigracionin
800-354-0365

E hënë-e premte, ora 9:00-18:00
Ofrohen shërbime interpretimi

Shteti i Nju-Jorkut-311

I disponueshëm gjatë gjithë ditës, çdo ditë
Pyesni rreth "imigracionit"
Ofrohen shërbime interpretimi

Organizata Family Legal Care
212-343-1122

E hënë - e premte, ora 9:00 - 13:00
dhe 14:00 - 17:00
Ofrohen shërbime interpretimi

Njihni të Drejtat Tuaja
nyc.gov/KnowYourRights

Mësoni për të drejtat tuaja dhe mbrojtjet e disponueshme.

Family Justice Centers (Qendrat e Drejtësisë për Familjet)
nyc.gov/FJC

Gjeni mbështetje dhe shërbime për të mbijetuarit e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.



Ky burim ofron vetëm informacion të përgjithshëm. Nuk përbën këshillë ligjore. Për këshillë ligjore, konsultohuni me një avokat.